



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi për zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2018-2020.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës për zbatimin e Vendimit Nr. 5029 të datës 13.07.2018 dhe Vendimit Nr. 2338 të datës 16.04.2018.
2. Vendimet e Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë në pikën 1. të këtij vendimi, për zbatimin e masës së përkohshme mbrojtëse në importin e pemëve dhe perimeve dhe për importin e qumështit, prodhojnë efekte juridike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të Qeverisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet grupi punues ndërministror për koordinimin e punës së të gjitha ministrive kompetente në lidhje me legjislacionin teknik i cili është përgjegjës për zbatimin e detyrave që dalin nga lëvizja e lirë e mallrave në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës.
2. Grupi punues përbëhet nga:
  - 2.1. Doruntinë Shala Hoxha - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/kryesuese;
  - 2.2. Gurakuq Kastrati - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/zv. kryesues;
  - 2.3. Hysni Komoni - Ministria e Zhvillimit Ekonomik/anëtar;
  - 2.4. Enver Tahiri - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/anëtar;
  - 2.5. Fejzullah Mustafa- Ministria e Infrastrukturës/anëtar;
  - 2.6. Driton Ademi - Ministria e Punëve të Brendshme/anëtar;
  - 2.7. Mentor Aliçkaj-Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare/anëtar;
  - 2.8. Rajmonda Kukalaj - Ministria e Integritimit Evropian /anëtare;
  - 2.9. Yllka Shabani - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/anëtare;
  - 2.10. Kujtim Uka - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës /anëtar;
  - 2.11. Granita Selimaj - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/anëtare;
  - 2.12. Ardiana Shala Krrabaj - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës/anëtare;
  - 2.13. Bujar Istogu - Agjencia Kosovare e Standardizimit/anëtar;
  - 2.14. Naim Hajra - Inspektorati i Tregut /anëtar;
  - 2.15. Isa Elshani - Agjencia e Metrologjisë e Kosovës/anëtar.
3. Përmes grupit të punës ministritë kompetente do të shkëmbejnë informacion për çështjet në vijim:
  - 3.1. Rregullat në lidhje me miratimin dhe zbatimin e rregulloreve teknike bazuar në rregullat e BE-së për harmonizim;

- 3.2. Rregullat në lidhje me miratimin dhe zbatimin e rregulloreve teknike në fushat që nuk janë rregulluar me rregullat e BE-së për harmonizim;
  - 3.3. Mirëmbajtjen e regjistrit sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 06/L -041 Për Kërkesat Teknike Për Produkte Dhe Vlerësim të Konformitetit, dhe shkëmbimin e informacionit përkatës dhe notifikimin e rregulloreve teknike në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.
4. Punët administrative dhe teknike të grupit punues i kryen Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
  5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ** .  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Prizrenit për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronës të ish Ndërmarrjes shoqërore "Kino Bistrica" dhe pronën e Ekonomisë Pyjore në pronësi të komunës, e cila aktualisht është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Prizrenit.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Njësia Kadastrale P-71813068-02134-3, me sipërfaqe 178 m<sup>2</sup>; P-71813068-02321-0, me sipërfaqe 765 m<sup>2</sup>; P71813068-02332-0 me sipërfaqe 498; nr. 800/1 dhe 800/2 ZK Korishë me sipërfaqe prej 474.434m<sup>2</sup>.
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Klinës për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronës të ish Ndërmarrjes shoqërore "KBI Malishgani" dhe kompania Boksitet e Kosovës' në pronësi të komunës, e cila aktualisht është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Klinës.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: ngastrat nr. 511/3 me sipërfaqe prej 5.94.11 ha (59411m<sup>2</sup>); nr. 511/4 me sipërfaqe prej 0.52.94 ha; nr. 511/5 me sipërfaqe prej 0.39.92 ha; nr. 525/2 me sipërfaqe prej 0.61.35 ha (6135m<sup>2</sup>); nr. 442/2 me sipërfaqe prej 0.26.05 ha (2605m<sup>2</sup>); nr.530/8 me sipërfaqe prej 0.09.39 ha (939m<sup>2</sup>); nr. 440/2 me sipërfaqe prej 0.03.20 ha (320m<sup>2</sup>); nr. 769/3 me sipërfaqe prej 0.84.29 ha (8429m<sup>2</sup>) nr. 696/1 me sipërfaqe prej 0.33.36ha (3336m<sup>2</sup>); nr. 197/1 me sipërfaqe prej 0.27.44 ha (2744m<sup>2</sup>); nr. 200/1 me sipërfaqe prej 230m<sup>2</sup>; nr. 93/60 me sipërfaqe prej 0.51.64 ha (5164m<sup>2</sup>); nr. 93/61 me sipërfaqe prej 0.11.53 ha (1153m<sup>2</sup>); nr. 93.66 me sipërfaqe prej 0.53.15 ha (5315m<sup>2</sup>); nr. 93/69 me sipërfaqe prej 01.36.37 ha (13637m<sup>2</sup>); nr. 93/75 me sipërfaqe prej 01.23.36 ha (12636m<sup>2</sup>); nr.195/8 me sipërfaqe prej 01.63.30ha (16330m<sup>2</sup>).
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Malishevës për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronës të ish Ndërmarrjes shoqërore "OPB-Mirusha" në pronësi të komunës, e cila aktualisht është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Malishevës.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Ngastrat Kadastrale; P-72310047-00492-0 me sipërfaqe prej 0.42.33 ha; P-72310047-00501-1 me sipërfaqe prej 2.38.16 ha.
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëfinancimin e Bursave në nivel të studimeve Master me Ambasadën e Republikës së Francës në Prishtinë.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti në Fushën e Turizmit.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti për Gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2017.
2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rekomandimi i Grupit Punues Teknik për drejtimin e Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës, që të vazhdohet me prodhimin e qymyrit nga fusha aktuale VERI (Ref.N1), deri në vitin 2027 respektivisht 2030, varësisht nga depozitat e qymyrit në atë fushë dhe validiteti i licencës për shfrytëzim dhe të vazhdohet me përfundimin e hulumtimeve.
2. Obligohet Korporata Energjetike e Kosovës që brenda 6 muajve të realizojë hulumtimet shtesë në Fusha JUG (Ref.S1.2).
3. Varësisht nga rezultatet e hulumtimit, Qeveria e Kosovës dhe KEK, të vendosë për orientimin strategjik dhe shfrytëzimin e resurseve në përputhje me legjislacionin në fuqi në sektorin minerar.
4. Nëse hulumtimet shtesë, nuk dëshmojnë rentabilitet të eksploatimit në Fushën JUG, atëherë KEK, të vazhdojë me zhvillimin e Minierës se Re, në fushën VERI (Ref.N1).
5. Nëse hulumtimet shtesë, dëshmojnë rentabilitet të eksploatimit në Fushën JUG, obligohet KEK, që të krijojë kushte për hartimin e Planit kryesor të xehetarisë, duke plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi në sektorin minerar.
6. Për qëllime të Projektit TC "Kosova e Re", referencë do të jetë fusha VERI (Ref.N1).
7. Obligohet Korporata Energjetike e Kosovës, në koordinim me institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/57

Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Arbër Taraku, emërohet udhëheqës i Projektit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve Endacakë.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
  - 2.1. Mbikëqyrë projektin "Menaxhimi dhe Kontrolli i Qenve Endacakë".
  - 2.2. Koordinon me institucionet relevante vendore çështjet e Menaxhimit dhe Kontrollit të Qenve Endacakë.
  - 2.3. Bashkëpunon me asociacionin e komunave dhe institucionet relevante lokale, për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve Endacakë.
  - 2.4. Përpilon rekomandimet për Kryeministrin, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe partnerët tjerë relevantë në lidhje me mbarëvajtjen e programit nacional për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve Endacakë.
  - 2.5. I raporton Kryeministrit për të gjitha aktivitetet të përcaktuara në këtë vendim.
3. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. I emëruari do të reflektojë pagën e shërbimit civil, të barasvlershme me koeficientin 9.
5. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për mbështetjen buxhetore dhe administrative të Udhëheqësit të Projektit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve Endacakë, nga buxheti i ndarë për projektin.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë